



BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar

Numër 9

D H J E T O R 2 0 2 1

BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVA
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO

Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve për Inflacionin

Numër 9

BOTUES

© Banka Qendrore e Republikës së Kosovës

Departamenti i Analizave Ekonomike
dhe i Stabilitetit Financiar

33 Garibaldi, Prishtinë 10000

Tel: ++383 38 222 055

Fax: ++383 38 243 763

Faqja e internetit

www.bqk-kos.org

Adresa elektronike

economic.analysis@bqk-kos.org

Përmbajtja

Anketa e Kreditimit Bankar	4
Hyrje	4
Përmbledhja e rezultateve	4
Kutia 1. Metodologjia	7
Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi.....	8
Kreditë ndaj ndërmarrjeve	8
Standardet kreditore	8
Kushtet dhe rregullat.....	9
Kërkesa për kredi.....	10
Kreditë ndaj ekonomive familjare	11
Standardet kreditore	11
Kushtet dhe rregullat.....	12
Kërkesa për kredi.....	12
Financimi	13
Rezultatet e pyetjeve të fokusuara	14
Pritjet për Inflacionin	16
Metodologjia	16
Përmbledhja e rezultateve	16

Anketa e Kreditimit Bankar

Hyrje¹

Me qëllim të rritjes së kapaciteteve analitike për një vlerësim sa më të mirë të dinamikave të kreditimit në Kosovë dhe pritjeve për zhvillimet në nivelin e çmimeve, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka dizajnuar dhe realizuar një anketë me bankat komerciale që operojnë në tregun bankar në Kosovë. Raporti që do të analizoj rezultatet e këtij anketimi do të publikohet në frekuencë tremujore në web-faqen e BQK-së, me qëllim që të ofrojë një pasqyrë më të gjerë rreth perceptimit të rrezikut të bankave dhe gatishmërinë e bankave për të dhënë hua, si dhe, sjelljes së ekonomive familjare dhe ndërmarrjeve kundrejt dinamikave në kreditim, si pasojë. Ky raport evidenton sjelljen kreditore për periudhën e tremujorit të tretë të vitit 2021, dhe pritjet e bankave për dinamikën në kreditim për tremujorin e katërt të vitit 2021.

Përveç pyetjeve standarde, në këtë anketë u shtuan edhe disa pyetje shtesë. Këto pyetje kanë për qëllim të pasqyrojnë ndikimin e masave kufizuese të aplikuara në Shtator 2021, si dhe në të njëjtën kohë pritjet për ndikimin e operacionalizimit të masave lehtësuese nga Pako e Ringjalljes Ekonomike në aktivitetin kreditor të bankave. Një nga pyetjet synon të elaboroj faktorët që kontribuan në rritjen e konsiderueshme të financimit nga depozitat. Gjithashtu, bëhet zberthimi i ofertës dhe kërkesës kreditore sipas sektorëve ekonomik.

Përmbledhja e rezultateve²

Si rezultat i përmirësimit të situatës së pandemisë bazuar në numrin e vogël të rasteve me Covid-19 dhe ecurisë së mirë me imunizimin e popullsisë, masat kufizuese u lehtësuan. Këto lehtësime mundësuan rikthimin në normalitet të aktivitetit ekonomik në dy muajt e parë të këtij tremujori, sidomos përmes numrit të madh të vizitave nga diaspora, e që për rrjedhojë ndikuan edhe në zgjerim të aktivitetit kreditor nga sektori bankar gjatë këtij tremujori. Rritja vjetore e stokut të gjithsej kredive tejkaloi nivelin e rritjes vjetore të kreditimit para pandemisë. Përderisa, kreditë e reja gjatë këtij tremujori edhe pse në vlerë të lartë, ishin më të ulëta krahasuar me tremujorin paraprak. Këto dinamika të kreditimit u ndikuan në masë më të madhe nga oferta kreditore, e cila u lehtësua deri në një masë, se sa nga kërkesa për kredi e cila kishte ndryshime marginale. Tutje, zhvillimet e lartpërmendura në ekonominë e vendit diktuan edhe pritjet e bankave, duke ndikuar në pritjet për lehtësim të ofertës kreditore dhe rritje të kërkesës për kredi deri në një masë gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021.

Sipas bankave, kreditimi i ndërmarrjeve gjatë këtij tremujori u ndikua pozitivisht kryesisht nga oferta kreditore, përderisa kërkesa për kredi nuk kishte ndryshime të rëndësishme. Në kuadër të ofertës kreditore, bankat raportuan se kanë lehtësuar deri në një masë standardet kreditore të aplikuara gjatë vlerësimit të aplikacioneve të ndërmarrjeve për kredi në tremujorin e tretë të vitit 2021. Standardet kreditore u lehtësuan në nivel më të lartë për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha (tabela 1). Ndryshimet në standardet kreditore u ndikuan pozitivisht kryesisht nga mbështetja e kredive nga FKGK, presioni i rritur i konkurrencës në sektorin bankar, si dhe rritja e tolerancës ndaj rrezikut.

¹ Për informata më të detajuara rreth qëllimit dhe historikut të anketës së kreditimit bankar në BQK, shikoni publikimin "Anketa e Kreditimit Bankar dhe Pritjeve të Inflacionit" Nr. 1.

² Pyetëtori dhe seria kohore e rezultateve të AKB-së janë në dispozicion në faqen e internetit të BQK-së, nën vegzën e Anketës së Kreditimit Bankar.

Për tremujorin e katërt të vitit 2021, pritjet e bankave konsistojnë në lehtësim në nivel më të lartë të standardeve kreditore se sa në tremujorin aktual. Ngjashëm me tremujorin aktual, oferta kreditore deri në një masë pritjet të jetë më e favorshme për NVM-të se sa për ndërmarrjet e mëdha. Pesë prej bankave pjesëmarrëse, e prej tyre tre me rëndësi sistemike, presin që mbështetja e FKGK-së për NVM-të të jetë faktori kyç në lehtësimin e standardeve kreditore. Gjithashtu, kontribut pozitiv në lehtësim pritjet të ketë edhe rritja e presioneve të konkurrencës nga bankat.

Kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet u lehtësuan, mirëpo në nivel të ulët. Kushte dhe rregulla të lehtësuara u aplikuan për të dy kategoritë e ndërmarrjeve përmes uljes së kërkesës për kolateral, uljes së normës së interesit, si dhe rritjes së shumës së kredisë në një nivel më të ulët. Faktorët që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave ishin mbështetja e NVM-ve nga FKGK dhe rritja e presioneve të konkurrencës në sektorin bankar. Ndërkohë, për tremujorin e katërt të vitit 2021, bankat presin lehtësime të kushteve dhe rregullave ngjashëm për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, në nivel marginalisht më të lartë se sa në tremujorin e tretë 2021. Kushtet dhe rregullat e lehtësuara pritjet të jenë të ngjashme me ato të aplikuara gjatë tremujorit aktual. Ngjashëm me tremujorin aktual, rritja e presioneve të konkurrencës në tregun bankar dhe mbështetja e ndërmarrjeve nga FKGK pritjet të kenë rolin kyç për këto lehtësime.

Gjatë tremujorit të tretë 2021, kërkesa e ndërmarrjeve për kredi bankare nuk shënoi ndryshim të rëndësishëm në krahasim me tremujorin paraprak. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet rezultoi të jetë mbivlerësuar në pritjet e bankave për TM3 2021 të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2021), ku bankat prisnin rritje deri në një masë të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet. Ndryshim marginal pozitiv në kërkesën për kredi kishte nga ndërmarrjet e mëdha, përderisa kërkesa nga NVM-të rezultoi e pandryshuar. Kërkesa për kredi nga ndërmarrjet, sipas deklaratave të bankave u nxit kryesisht nga rritja e kërkesës për financimin investimeve fikse dhe financimin e inventarëve dhe kapitalit punues, edhe pse të dy këta faktorë u karakterizuan me indeks të ulët pozitiv. Pritjet për aktivitet të rritur ekonomik në vend mund t'i kenë ndikuar edhe pritjet e bankave për kërkesë më të lartë për kredi gjatë tremujorit të ardhshëm krahas këtij aktual nga të dy kategoritë e ndërmarrjeve, veçanërisht nga NVM-të (tabela 1). Faktorët potencial që pritjet të ndikojnë në rritjen e kërkesës për kredi nga ndërmarrjet janë nevoja për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe financimin e investimeve fikse, me intensitet deri në një masë më të lartë krahas tremujorit aktual.

Kreditë e reja për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë 2021 kishin rritje në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Ngjashëm me kreditimin e ndërmarrjeve, oferta kreditore ishte nxitësi kryesor i dinamikave të aktivitetit kreditues për ekonomitë familjare gjatë periudhës raportuese, përderisa kërkesa kreditore kishte rol më të dobët në këtë aspekt. Standardet kreditore në tremujorin aktual, në përgjithësi rezultojnë të jenë të përafërta me pritjet e bankave të shprehura në anketën e kaluar, mirëpo nëse e zbërthejmë sipas qëllimeve të kredive (për blerjen e shtëpive dhe konsumuese) atëherë pritjet e bankave nuk korrespondojnë me vlerat aktuale. Standardet kreditore u lehtësuan deri në një masë, e në veçanti për kreditë konsumuese. Këto lehtësime u ndikuan kryesisht nga perspektiva e përmirësuar e tregut vendor. Gjithashtu, bankat presin që lehtësime të tilla të standardeve kreditore në një nivel të përafërt me këtë tremujor të vazhdojnë për ekonomitë familjare edhe gjatë tremujorit të ardhshëm, e veçanërisht për kreditë konsumuese (tabela 1). Presioni i rritur i konkurrencës në sektorin bankar pritjet të jenë faktori kyç përcaktues i standardeve kreditore të aplikuara nga bankat për ekonomitë familjare.






Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare u lehtësuan deri në një masë. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese. Kushtet dhe rregullat u lehtësuan kryesisht përmes uljes së kërkesës për kolateral, zgjatjes së maturitetit të kredive, si dhe në një nivel më të ulët përmes uljes së normës së interesit dhe rritjes së shumës së kredisë. Faktorët kyç që ndikuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të

kreditimit për ekonomitë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 ishin presioni i rritur i konkurrencës, perspektiva e mirë në tregun vendor në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti, si dhe pozita e favorshme e likuiditetit të bankave. Për tremujorin e katërt të vitit 2021, bankat deklaruan se presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen në masë më të madhe se sa në tremujorin aktual. Lehtësim i kushteve dhe rregullave pritet për të dy llojet e kredive, mirëpo për kreditë konsumuese bankat pritet të ofrojnë kushte dhe rregulla më të volitshme. Të gjitha kushtet dhe rregullat e listuara në anketë pritet të lehtësohen përveç pagesave tjera përveç interesit e cila pritet të mbetet e pandryshuar. Rritja e presioneve të konkurrencës, perspektiva e mirë e tregut bankar, si dhe pritja për lehtësim të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 pritet të jenë faktorë nxitës të lehtësimeve të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM4 2021.

Përkundër masave të lehtësuara gjatë pjesës më të madhe të tremujorit aktual dhe rikthimit në normalitet të ekonomisë së vendit, kërkesa për kredi nga ekonomitë familjare shënoi rritje dukshëm më të ulët krahasuar me tremujorin paraprak. Bankat raportuan për rritje të ngjashme të kërkesës si për kreditë për blerjen e shtëpive ashtu edhe për kreditë konsumuese. Saktësisht, pesë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë, deklaruan rritje të kërkesës për kredi në përgjithësi përderisa tri banka deklaruan rënie të kërkesës për kredi. Bankat raportuan se kjo rritje u ndikua pozitivisht nga prospektet e favorshme në tregun e patundshmerisë dhe nevoja për financimin e shpenzimeve të konsumit. Në tremujorin e katërt, bankat presin rritje të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare mirëpo në nivel më të lartë në krahasim me tremujorin aktual, e veçanërisht për kreditë konsumuese (tabela 1). Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat presin që të njëjtët faktorë që ndikuan kërkesën për kredi në këtë tremujor të kontribuojnë edhe gjatë tremujorit të ardhshëm mirëpo me një intensitet më të ulët.

Tabela 1. Vlerësimi i bankave për ndryshimet në ofertën dhe kërkesën kreditore

	Oferta (Standardet kreditore)		Kërkesa	
	TM3 2021	TM4 2021 (pritjet)	TM3 2021	TM4 2021 (pritjet)
Ndërmarrjet	↗	↑	↗	↑
NVM	↗	↑	→	↑
Ndërmarrjet e mëdha	↗	↗	↗	↗
Ekonomitë familjare	↑	↑	↗	↑
Kredi për blerjen e shtëpive	↗	↗	↗	↗
Kredi konsumuese	↑	↑	↗	↑

 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv mbi 0.20)
 Lehtësim i standardeve kreditore/Rritje e kërkesës për kredi (indeks pozitiv nën 0.20)
 Kryesisht pandryshime (indeks pozitiv/negativ deri 0.05)
 Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ nën 0.20)
 Shtërngim i standardeve kreditore/Rënie e kërkesës për kredi (indeks negativ mbi 0.20)

Burimi: BQK.

Masat lehtësuese rregullatore të ndërmarrja nga BQK si moratoriumi dhe ristrukturimet mundësuan që rreziku kreditor të qëndroj në nivele të ulëta. Sidoqoftë, ndjeshmëria e sektorit ndaj këtij rreziku mund të shfaqet pas maturimit të kredive të ristrukturuara – fundi i vitit 2021. Bankat deklaruan përkeqësim të portfolios kreditore, pasi që indeksi i përgjigjeve në këtë tremujor kaloi në pozitiv nga indeksi negativ në tremujorin e kaluar, e që nënkupton rritje të raportit në mes kredive jo-performuese dhe gjithsej kredive. Ky indeks reflekton kryesisht përgjigjet për ndërmarrjet, ku katër

banka pjesëmarrëse e prej tyre tre me rëndësi sistemike deklaruan për rritje të këtij indikator. Në tremujorin e ardhshëm, periudhë që korrespondon me maturimin e ristrukturimeve, bankat presin rritje të mëtutjeshme të kredive jo-performuese, e në veçanti tek portfolio e ekonomive familjare.

Për dallim nga anketa e kaluar, rezultatet e anketës për periudhën në fjalë tregojnë që financimi i bankave u rrit konsiderueshëm në krahasim me tremujorin e kaluar. Financimi i bankave në këtë tremujor u dominua nga rritja e konsiderueshme e depozitave afatshkurtra të ekonomive familjare. Saktësisht, tetë banka deklaruan rritje të depozitave nga ekonomitë financiare, ku prej tyre dy banka me rëndësi sistemike deklaruan rritje të konsiderueshme. Bankat i atribuon rritjen e depozitave hezitimit për investim nga subjektet ekonomike, dërgesave të larta të remitencave, si dhe vizitave në numër të lartë të diasporës në vend gjatë këtij tremujori. Përderisa, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve dhe nga institucionet financiare ndërkombëtare shënoi rënie, mirëpo në nivel të ulët. Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin që rritja e financimit të vazhdojë përmes rritjes së depozitave afatshkurtra nga ekonomitë familjare edhe pse në nivel më të ulët se sa gjatë tremujorit aktual. Për dallim nga ky tremujor, pritet që financimi nga depozitat e ndërmarrjeve të kontribuojë pozitivisht në financimin e sektorit.

Kutia 1. Metodologjia

Pyetësi i Anketës së Kreditimit Bankar

Pyetësi i AKB është i bazuar në forma të standardizuara të pyetësorëve të përdorur nga Bankat Qendrore të vendeve të eurozonës dhe më gjerë. Megjithatë, pyetësi i BQK për AKB është modifikuar dhe përshtatur që në mënyrën më të mirë dhe më gjithëpërfshirëse të paraqet zhvillimet e kreditimit në sektorin bankar në Kosovë.

Pyetësi i AKB përbëhet nga 19 pyetje, të cilat mbulojnë ndryshimet në ofertën dhe kërkesën për kredi, faktorët që kontribuojnë në këto ndryshime si dhe qasjen në financim të sektorit bankar, në baza tre mujore. Pyetjet mbi kreditimin bankar fokusohen në dy kategori kryesore: (i) kreditë ndaj ndërmarrjeve, dhe (ii) kreditë ndaj ekonomive familjare. Për më tepër, kreditë ndaj ndërmarrjeve nën-kategorizohen në kreditë ndaj NVM-ve dhe kreditë ndaj ndërmarrjeve të mëdha, përderisa kreditë ndaj ekonomive familjare nën-kategorizohen në kreditë për blerjen e shtëpive dhe kreditë konsumuese. Për të gjitha kategoritë e lartpërmendura, ndryshimet në ofertën kreditore përcaktohen nga standardet kreditore të aplikuara gjatë aprovimit të kredive, kushtet dhe rregullat e aplikuara për kreditë e reja, norma e aprovimit të kredive, si dhe faktorët që ndikojnë në ndryshimet e tyre. Ndërsa, ndryshimet në kërkesën për kredi përcaktohen nga kërkesa për kredi (numri i aplikacioneve për kredi), cilësia e aplikacioneve të pranuar për kredi, si dhe faktorët që e ndikojnë kërkesën për kredi. Pyetjet e anketës kryesisht janë të formuluar për ndryshimet gjatë tre muajve paraprak dhe pritet për tre muajt e ardhshëm. Gjithashtu, pyetjet mbulojnë kreditë edhe në aspekt të maturimit të tyre dhe valutës në të cilën lëshohen.

Përveç pyetjeve standarde, pyetësi i AKB mund të përmbajë edhe pyetje shtesë mbi çështje specifike me interes për shpjegimin e zhvillimeve në sektorin bankar. Përderisa pyetjet standarde mbulojnë një periudhë tre-mujore, pyetjet shtesë mund t'i referohen ndryshimeve gjatë një periudhe kohore më të gjatë. Në anketim marrin pjesë nëntë nga dhjetë bankat që operojnë në Kosovë³. Rrjedhimisht, bankat pjesëmarrëse përfaqësojnë tregun e përgjithshëm bankar dhe sigurojnë një përfaqësim të duhur statistikor, duke marrë parasysh se përfaqësojnë rreth 98 përqind të aseteve të gjithsej sektorit bankar dhe 99.8 përqind të gjithsej kreditimit në sektorin bankar.

Pjesëmarrësve të anketës u kërkohet të tregojnë në mënyrë cilësore forcën e çdo shtrëngimi ose lehtësimi apo forcën e çdo ulje ose rritje, duke raportuar ndryshimet përmes pesë shkallëve si: (i) shtrënguar / ulur në mënyrë të konsiderueshme, (ii) shtrënguar / ulur në një masë, (iii) e pandryshuar, (iv) lehtësuar / rritur në një masë ose (v) lehtësuar / rritur në mënyrë të konsiderueshme.

Gjenerimi i rezultateve të anketës së kreditimit bankar

Kuantifikimi i përgjigjeve të marra nga bankat individuale dhe agregimi i tyre për të paraqitur ndryshimet në nivel sektori arrihet përmes gjenerimit të një indeksi. Ky indeks gjenerohet për çdo kategori e nën-kategori të

³ Banka e cila nuk është përfshirë në anketë është Komercialna Banka e cila ka aktivitet kreditor të limituar.

secilës pyetje, duke dhënë në këtë mënyrë një njësi kuantifikuese për përgjigjet e marra në nivel të sektorit. Fillimisht, përgjigjeve u përcaktohet një vlerë në bazë të forcës së ndryshimeve, konkretisht përgjigjeve ku bankat kanë deklaruar shtrëngim/ulje të konsiderueshme u përcaktohet vlera - 1, vlerë dyfish më e madhe se ajo e përcaktuar për përgjigjet kur bankat deklarojnë shtrëngim / ulje deri në një masë (vlerë prej -0.5). Ngjashëm, përgjigjet kur kemi lehtësim/rritje të konsiderueshme kanë vlerë 1, përderisa ato me lehtësim/rritje deri në një masë u përcaktohet vlera 0.5. Rezultatet po ashtu janë të peshuara në bazë të peshës që secila prej bankave ka në gjithsej kreditimin e sektorit bankar. Përfundimisht, pesha e secilës bankë sipas pjesëmarrjes në tregun e kredive shumëzohet me vlerën e përcaktuar në bazë të intensitetit të përgjigjes së dhënë, duke fituar indeksin në fjalë.

Më tutje, agregimi i indeksit në nivel sektori bëhet përmes shumës së indekseve të fituara për secilën bankë. Vlerat e indeksit janë në mes të -1 dhe 1, ku vlerat pozitive të indeksit paraqesin lehtësim, rritje apo kontribut pozitiv dhe në kontrast vlerat negative paraqesin shtrëngim, rënie apo kontribut negativ.


Zhvillimet në standardet kreditore, në kushtet dhe rregullat kreditore, si dhe në kërkesën për kredi

Kreditë ndaj ndërmarrjeve

Standardet kreditore

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, standardet kreditore (udhëzimet e brendshme të bankave apo kriteret për aprovimin e kredive) të aplikuara për ndërmarrjet në përgjithësi paraqesin lehtësim, edhe pse më të ulët në krahasim me tremujorin paraprak me indeks pozitiv prej 0.15 nga 0.28 në anketën paraprake. Në anketën e kaluar (TM2 2021), bankat kishin deklaruar se presin standarde kreditore të lehtësuara në një nivel të përafërt me atë aktual (grafiku 1).

Grafik 1. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuon



Në kuadër të kredive për ndërmarrjet, bankat deklaruan indeks pozitiv 0.15 për ndryshimet në standardet kreditore për NVM-të, dhe ndryshime marginale me indeks pozitiv më të ulët 0.06 për ndërmarrjet e mëdha. Saktësisht, ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e dy bankave pjesëmarrëse të cilat deklaruan lehtësim deri në një masë të standardeve kreditore për NVM-të, përderisa vetëm një nga bankat deklaroi të njëjtën për ndërmarrjet e mëdha.

Rol kryesor në lehtësimin e standardeve kreditore të aplikuara nga bankat në TM3 2021, rezulton të kenë luajtur mbështetja e ndërmarrjeve në kreditim nga FKGK me një indeks pozitiv prej 0.46 (përgjigje nga katër banka, prej tyre tre i atribuon kontribut të konsiderueshëm), rritja e presioneve të konkurrencës në tregun bankar me indeks pozitiv prej 0.28 (faktorë i deklaruar nga dy banka me rëndësi sistematike dhe peshë të madhe në kreditimin e sektorit), si dhe me indeks më të ulët prej 0.19

rritja e tolerancës ndaj rrezikut. Pas indeksimit të përgjigjeve, masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 rezultuan me indeks të ulët mirëpo pozitiv prej 0.18, rezultat jo i pritur duke marr parasysh që gjatë muajit shtator, si pasojë e rritjes së konsiderueshme të rasteve të infektimit me Covid-19, pati kufizim të lëvizjes dhe aktivitetit ekonomik, kryesisht të sektorit të shërbimeve. Bazuar edhe në performancën e sektorit bankar mund të sugjerohet se përgjigjet e bankave më shumë iu atribuon periudhës Korrik dhe Gusht, gjatë së cilës masat kufizuese u lehtësuan konsiderueshëm. Norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet nuk kishte ndryshime të rëndësishme gjatë këtij tremujori, ku lëvizje pozitive edhe pse marginale kishte për ndërmarrjet e mëdha, ky rezultat u ndikua me shumë nga fakti që një prej bankave me peshë të lartë në kreditim deklaroi shtrëngim të aprovimit deri në një masë për NVM-të, kështu duke ndikuar që norma e aprovimit për ndërmarrjet e mëdha të rezultojë pozitive.


Bankat pritjet t'i lehtësojnë standardet kreditore deri në një masë gjatë TM4 2021, duke u bazuar në pritjet për rikthimin në normalitet të aktivitetit ekonomik në vend, si rezultat i tejkalimit të valës së fundit të infektiveve me Covid-19, numrit të lartë të vaksinimeve dhe lehtësimit të masave kufizuese. Pesë nga nëntë bankat pjesëmarrëse në anketë, prej tyre tre me rëndësi sistematike, presin që mbështetja e FKGK-së për NVM-të të vazhdojë të ketë kontributin kryesor në lehtësim të standardeve kreditore për ndërmarrjet. Gjithashtu, kontribut pozitiv pritet të ketë rritja e presionit nga konkurrenca në sektorin bankar. Konkretisht, lehtësimi i standardeve kreditore pritet të jetë në një nivel më të lartë se sa ndryshimi në tremujorin aktual, ku pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi një indeks pozitiv për NVM-të prej 0.26, dhe indeks pozitiv prej 0.09 për ndërmarrjet e mëdha.

Njëkohësisht, në nivel të njëjtë me lehtësimin e standardeve kreditore pritet të rritet edhe norma e aprovimit të kredive për ndërmarrjet, kryesisht për NVM-të.

Kushtet dhe rregullat

Në TM3 2021, në përgjithësi, kushtet dhe rregullat e aplikuara nga bankat me rastin e dhënies së kredive për ndërmarrjet (kushtet dhe rregullat përkatëse të një kontrate të caktuar për kredi) u lehtësuan mirëpo në një nivel të ulët (grafiku 2). Sektori bankar aplikoi lehtësim të njëjtë të kushteve dhe rregullave për kreditë e reja si për NVM-të ashtu edhe për ndërmarrjet e mëdha. Konkretisht, për të dy kategoritë e ndërmarrjeve lehtësim deri në një masë kishte në normën e interesit të aplikuar dhe në kërkesën për kolateral për kreditë e aprovuara me indeks pozitiv prej 0.16. Gjithashtu, bankat ofruan madhësi më të volitshme të kredive për ndërmarrjet me indeks pozitiv prej 0.11.

Grafik 2. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ndërmarrjet



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Faktori me kontributin kryesor dhe indeks të lartë pozitiv në lehtësimin e kushteve dhe rregullave vazhdon të jetë mbështetja e NVM-ve nga FKGK me indeks pozitiv prej 0.41. Gjithashtu, pozitivisht kontribuoi edhe rritja e presioneve të konkurrencës nga sektori bankar me indeks pozitiv prej 0.29.

Bankat gjatë TM4 2021 pritet të aplikojnë kushte dhe rregulla të lehtësuara mirëpo në nivel të ulët. Në këtë kontekst, ngjashëm me tremujorin aktual bankat deklaruan që presin lehtësim të ngjashëm të kushteve dhe rregullave për të dy kategoritë e ndërmarrjeve, përmes ofrimit të çmimit më të volitshëm për kredi (indeks pozitiv 0.19), rritjes së madhësisë së shumës së kredive (indeks pozitiv 0.17 për NVM-të dhe 0.14 për ndërmarrjet e mëdha), si dhe kërkesave më të ulëta për kolateral (indeks pozitiv 0.16). Lehtësimet në kushtet dhe rregullat e ndërmarrjeve pritet të nxiten nga presionet e konkurrencës në tregun bankar, mbështetja e NVM-ve nga FKGK, si dhe pritjet për lirim e masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 gjatë TM4.


Kërkesa për kredi

Gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021, kërkesa për kredi nga ana e ndërmarrjeve nuk shënoi ndryshim të rëndësishëm krahasuar me TM2 2021. Kërkesa për kredi rezultoi të jetë mbivlerësuar në pritjet e bankave për TM3 2021 të shprehura në anketën e kaluar (TM2 2021), ku bankat prisnin rritje deri në një masë të kërkesës për kredi nga ndërmarrjet (grafiku 3). Konkretisht, kërkesa për kredi nga NVM-të mbeti e pandryshuar me indeks pozitiv prej 0.02, përderisa kërkesa kreditore nga ndërmarrjet e mëdha rezultoi në një indeks pozitiv marginal 0.09. Indeksi i gjeneruar për kërkesën për kredi u ndikua nga përgjigjet e tri bankave të cilat deklaruan rritje deri në një masë të kërkesës, përderisa dy banka deklaruan rënie të kërkesës, prej tyre një bankë me rëndësi sistemike dhe peshë të madhe në kreditimin e sektorit bankar.

Sipas anketës, ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet u ndikuan kryesisht nga kërkesa për financimin e investimeve fikse dhe financimin e inventarëve dhe kapitalit punues edhe pse me indeks pozitiv të ulët prej 0.10 dhe 0.13, respektivisht. Rezultati i faktorëve kontribuues në kërkesën për kredi u përcaktua nga përgjigjet e katër bankave të cilat deklaruan ndikim pozitiv të dy faktorëve kontribuues, përderisa dy banka, prej tyre njëra me rëndësi sistemike, deklaruan ndikim negativ të faktorëve të njëjtë. Njëkohësisht, cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ndërmarrjet nuk kishte ndryshime të rëndësishme gjatë TM3 2021.

Sipas anketës, gjatë TM3 2021 raporti i kredive jo-performuese të ndërmarrjeve ndaj gjithsej kredive gjeneroi indeks pozitiv prej 0.14, për dallim nga anketa e kaluar ku bankat deklaruan indeks negativ të këtij raporti. Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e katër bankave të cilat deklaruan rritje të kredive joperformuese, edhe pse një nga bankat me peshë të lartë në kreditim deklaroi rënie të kredive jo-performuese.

Grafik 3. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ndërmarrjet dhe faktorët që kontribuan



Pritjet për aktivitet të rritur ekonomik në vend, si pasojë e përmirësimit të gjendjes së pandemisë dhe ecurisë së vaksinimit në vend gjatë tremujorit të ardhshëm, mund t'i ketë shtyrë bankat që të presin kërkesë për kredi më të lartë se sa në tremujorin aktual. Kërkesa pritet të ketë rritje dukshëm më të

lartë për të dy segmentet e ndërmarrjeve krahasuar me TM3 2021, e veçanërisht për NVM-të me indeks pozitiv prej 0.33. Faktorë me kontribut pozitiv në kërkesën për kredi pritet të jenë nevoja për financimin e inventarëve dhe kapitalit punues dhe investimeve fikse me indeks pozitiv prej 0.29 dhe 0.22, respektivisht. Njëkohësisht, bankat presin përmirësim të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ndërmarrjet krahasuar me tremujorin aktual.

Gjatë tremujorit të ardhshëm, bankat presin që raporti i kredive jo-performuese për ndërmarrjet të vazhdoj të mbetet me indeks pozitiv edhe pse më të ulët se sa në tremujorin aktual, saktësisht 0.11.


Kreditë ndaj ekonomive familjare

Standardet kreditore

Standardet kreditore të aplikuara për ekonominë familjare gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021 përgjithësisht u lehtësuan, duke gjeneruar indeks pozitiv prej 0.18 për kreditë për blerjen e shtëpive dhe indeks pozitiv prej 0.23 për kreditë konsumuese. Pritjet për tremujorin e tretë të deklaruar nga bankat në anketën e kaluar, gjithashtu sugjeronin për lehtësim të standardeve kreditore të aplikuara mirëpo në masë më të madhe për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për ato konsumuese (grafiku 4). Bankat deklaruan të kenë rritur dukshëm normën e aprovimit të kredive për ekonominë familjare, dhe atë në një masë më të madhe për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.33, se sa për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.25.

Faktorë që kontribuan pozitivisht në lehtësimin e standardeve kreditore ishin perspektiva e mirë e tregut të brendshëm (indeks pozitiv prej 0.30), lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19 (indeks pozitiv prej 0.18), si dhe në një nivel më të ulët perspektiva e mirë e bankave amë (indeks pozitiv prej 0.15).

Grafik 4. Ndryshimet në standardet kreditore të aplikuara për ekonominë familjare dhe faktorët që kontribuan




Burimi: BQK.

Në tremujorin e katërt 2021, bankat presin standarde kreditore të lehtësuara deri në një masë për ekonominë familjare. Standardet kreditore pritet të lehtësohen në një nivel më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive, me indeks pozitiv prej 0.28 dhe 0.13, respektivisht. Standardet kreditore pritet të ndikohen pozitivisht nga rritja e presioneve të konkurrencës. Njëkohësisht, bankat presin rritje të nivelit të aprovimit të kredive në nivel të përafërt me vlerat aktuale në TM3 2021. Niveli i aprovimit të kredive pritet të rritet në një masë më të madhe për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.35 dhe 0.27, respektivisht.

Kushtet dhe rregullat

Kushtet dhe rregullat për kreditë e reja për ekonomitë familjare përgjithësisht u lehtësuan në tremujorin e tretë të vitit 2021. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave ishte më i lartë për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese bazuar në numrin e kushteve të lehtësuara. Pothuajse të gjitha kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive të përfshira në anketë u lehtësuan, përveç pagesave tjera përveç interesit që mbetën të pandryshuara. Saktësisht, bankat aplikuan normë më të ulët të interesit (indeks pozitiv prej 0.12), ulën kërkesat për kolateral (indeks pozitiv prej 0.15), rritën shumën e kredive të aprovuara (indeks pozitiv prej 0.12), si dhe zgjatën maturitetin e kredive (indeks pozitiv prej 0.14). Ndërsa për kreditë konsumuese bankat aplikuan lehtësime në nivel të njëjtë mirëpo në vetëm dy prej kushteve, kryesisht në kërkesat për kolateral (indeks pozitiv prej 0.15) dhe në normën e interesit (indeks pozitiv prej 0.12) (grafiku 5).

Grafik 5. Ndryshimet në kushtet dhe rregullat e aplikuara për ekonomitë familjare



Burimi: BQK.

* Vlera e pritur

Faktorët kryesor që kontribuan në lehtësimin e kushteve dhe rregullave të aplikuara janë kryesisht presioni i rritur i konkurrencës, perspektiva e mirë e tregut vendor në përgjithësi dhe atij bankar në veçanti, si dhe pozita e kënaqshme e likuiditetit të sektorit. Gjithashtu, në këto lehtësime ndikoi edhe lehtësimi i masave kufizuese për parandalimin e shpërndarjes së virusit Covid-19, duke iu referuar muajve korrik dhe gusht 2021, pasi që këto masa u rikthyen gjatë muajit shtator.

Për tremujorin e katërt të vitit 2021, bankat presin që kushtet dhe rregullat për kredi për ekonomitë familjare të lehtësohen në një masë më të madhe se sa gjatë tremujorit aktual. Lehtësimi i kushteve dhe rregullave pritet të jetë deri në një masë më të lartë për kreditë konsumuese se sa për kreditë për blerjen e shtëpive. Kryesisht, kushtet dhe rregullat për kreditë për blerjen e shtëpive pritet të lehtësohen përmes zvogëlimit të normës së interesit me indeks pozitiv prej 0.23, uljes së kërkesave për kolateral me indeks pozitiv prej 0.15, si dhe në një nivel më të ulët përmes zgjatjes së maturitetit dhe rritjes së shumës së aprovuar, saktësisht indeks pozitiv 0.11 dhe 0.10, respektivisht. Të njëjtat kushte pritet të lehtësohen edhe për kreditë konsumuese, për më tepër edhe indeksi nga përgjigjet rezultoi i njëjtë për lehtësimet në normën e interesit dhe kërkesat për kolateral (0.23 dhe 0.15, respektivisht). Përderisa dallimi qëndron në zgjatjen e maturitetit dhe rritjen e shumës së kredive të aprovuara me indeks pozitiv prej 0.20 dhe 0.19, respektivisht. Rritja e presioneve të konkurrencës në tregun bankar, perspektiva e mirë e tregut bankar, si dhe pritja për lehtësim të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së virusit Covid-19 pritet të jenë faktorët nxitës të lehtësimeve të kushteve dhe rregullave të aplikuara nga bankat gjatë TM4 2021.

Kërkesa për kredi


Krahasuar me rritjen e konsiderueshme të kërkesës për kredi nga ekonomitë familjare gjatë tremujorit të kaluar (TM2 2021), bankat këtë tremujor raportuan për rritje të ulët të kërkesës nga ekonomitë familjare. Pesë nga gjithsej nëntë banka pjesëmarrëse në anketë deklaruan rritje të

kërkesës për kredi në përgjithësi dhe tri nga bankat raportuan rënie të kërkesës për kredi, e që si pasojë pas indeksimit të përgjigjeve rezultoi indeks pozitiv të ulët prej 0.20. Bankat raportuan për rritje më të lartë të kërkesës për kreditë për blerjen e shtëpive se sa për kreditë konsumuese me indeks pozitiv prej 0.13 dhe 0.12, respektivisht. Nëse krahasojmë rezultatet aktuale të kërkesës për kredi me pritjet e bankave të deklaruara në anketën e kaluar për të njëjtën periudhë, niveli aktual i rritjes së kërkesës është më i ulët, ndikuar nga vlera aktuale e kërkesës për të dy kategoritë të cilat janë më të ulëta se sa pritjet e deklaruara nga bankat (grafiku 6).

Kjo rritje u ndikua pozitivisht kryesisht nga dy prej faktorëve të listuar në anketë, saktësisht nga përmirësimi i perspektivës në tregun e patundshmërive dhe nevojës për financim të konsumit me indeks pozitiv prej 0.13 dhe 0.17, respektivisht. Cilësia e aplikacioneve të pranuar nga ekonomitë familjare për kredi gjatë këtij tremujori u përmirësua për të dy llojet e kredive, e veçanërisht për kreditë konsumuese (indeks pozitiv prej 0.20).

Sa i përket portfolios kreditore për ekonomitë familjare, bankat nuk deklaruan ndryshime të rëndësishme në cilësinë e portfolios kreditore. Ndryshimet në cilësinë e portfolios reflektuan përgjigjet për rënie të raportit të kredive jo-performuese ndaj gjithsej kredive për ekonomitë familjare nga dy banka dhe rritje të këtij raporti nga dy banka tjera, e që ndikuan në një indeks pothuajse të pandryshuar.

Grafik 6. Ndryshimet në kërkesën për kredi nga ekonomitë familjare dhe faktorët që kontribuan



Në tremujorin e katërt të vitit 2021, bankat presin rritje të kërkesës për kredi deri në një masë për ekonomitë familjare, mirëpo në nivel më të lartë se sa rritja në tremujorin aktual. Bankat deklaruan se presin rritje të kërkesës për kredi për blerjen e shtëpive me indeks pozitiv prej 0.16, përderisa kërkesa për kredi konsumuese rezultoi me indeks pozitiv prej 0.31. Rezultatet e anketës sugjerojnë se bankat ia atribuuan këto pritje perspektivës së mirë në tregun e patundshmërive dhe rritjes së kërkesës për financim të shpenzimeve tjera.

Për dallim nga tremujori aktual (TM3 2021) bankat presin që cilësia e portfolios kreditore e ekonomive familjare të përkeqësohet gjatë tremujorit të katërt të vitit 2021. Këto pritje u reflektuan në indeks pozitiv prej 0.17.

Njëkohësisht, bankat deklaruan se presin përmirësim në një nivel të ulët të cilësisë së aplikacioneve për kredi nga ekonomitë familjare, kryesisht për kreditë për blerjen e shtëpive me një indeks pozitiv prej 0.11.

Financimi


Bankat raportuan rritje të konsiderueshme të qasjes në financim gjatë tremujorit të tretë të vitit 2021. Duke marrë parasysh modelin tradicional të sektorit bankar në Kosovë, financimi vazhdoi të dominohet nga depozitat e ekonomive familjare. Nga nëntë banka pjesëmarrëse në anketë, tetë

deklaruan rritje të financimit gjatë këtij tremujori, dy prej tyre (banka me peshë të madhe dhe me rëndësi sistematike në sektor) deklaruan rritje të konsiderueshme të financimit.

Për dallim nga anketa e kaluar, rezultatet tregojnë që financimi i bankave u rrit në nivel dukshëm më të lartë, ku dominuan depozitat afatshkurtra të ekonomive familjare me një indeks prej 0.65 (0.23 në TM2 2021). Ky rezultat u ndikua nga përgjigjet e tetë nga gjithsej nëntë bankave pjesëmarrëse në anketë. Përderisa, financimi nga depozitat e ndërmarrjeve dhe financimi nga institucionet ndërkombëtare financiare kontribuuan negativisht në financimin e sektorit bankar mirëpo me një indeks marginal prej 0.10 dhe 0.06, respektivisht (grafiku 7). Sipas maturitetit, depozitat afatshkurtra ishin burimi kryesor për financim gjatë këtij tremujori me një indeks pozitiv prej 0.47.

Për tremujorin e ardhshëm, në përgjithësi bankat presin rritje deri në një masë të qasjes në financim, mirëpo me një ritëm përgjysmë më të ngadalshëm se sa ai i tremujorit aktual. Financimi përmes depozitave të ekonomive familjare pritet të prij rritjen e financimit të sektorit bankar me indeks pozitiv prej 0.48, pasuar nga financimi nga depozitat e ndërmarrjeve me indeks pozitiv prej 0.22. Gjithashtu, bankat deklaruan se presin që rritjen e financimit ta dominojnë depozitat me maturitet afatshkurtër me indeks pozitiv 0.41 (grafiku 7).

Grafik 7. Ndryshimet në financimin e sektorit bankar



Rezultatet e pyetjeve të fokusuara

Pyetësori i anketës për tremujorin e tretë 2021 është plotësuar me katër pyetje shtesë me qëllim të kuptimit të ndikimit të masave kufizuese për parandalimin e përhapjes së Covid-19 dhe operacionalizimit të masave lehtësuese kundër efekteve të Covid-19 në sjelljen e sektorit bankar kundrejt kreditimit të sektorëve ekonomik. Gjithashtu, shpjegohen dinamikat e ofertës dhe kërkesës kreditore të zbërthyer sipas sektorëve ekonomik. Në pyetjet shtesë, gjithashtu u përfshi pyetja rreth faktorëve që nxitën rritjen e theksuar të depozitave në sektorin bankar deri në tremujorin e tretë 2021.

Në fund të muajit gusht dhe gjatë pjesës më të madhe të muajit shtator 2021 për shkak të rritjes së konsiderueshme të numrit të infektuarve me Covid-19 dhe mbingarkesës së sektorit shëndetësor, qeveria rikthej masat kufizuese për parandalimin e përhapjes së mëtutjeshme të virusit. Këto masa kryesisht ndikuan sektorin e shërbimeve, saktësisht gastroniminë dhe hotelerinë. Në pyetjen shtesë mbi ndikimin e rikthimit të masave në aktivitetin kreditor të sektorit bankar, kryesisht bankat deklaruan se nuk është vërejt ndikim i theksuar, pasi ndikimi ishte i kufizuar vetëm në sektorë të caktuar. Bankat me ekspozim më të lartë në sektorët e prekur nga masat deklaruan për ndikim negativ edhe pse minimal. Sidoqoftë, pjesa më e madhe e bankave theksuan se nëse masa të tilla përsëriten edhe gjatë TM4 pritet që ky ndikim të thellohet dhe vështirësitë e sektorëve të prekur të dalin në pah dhe të materializohen.

Gjatë muajit gusht 2021 u diskutua për operacionalizimin e dy prej masave lehtësuese nga Pako e Ringjalljes Ekonomike, saktësisht masa 2.1 për subvencionimin e kredive investive dhe masa 3.6 për mbështetjen e likuiditetit familjar (fillon në muajin tetor 2021). Një nga pyetjet shitesë në anketë lidhet me pritjet e bankave për efektin që këto masa mund të kenë në aktivitetin kreditor të tyre. Pesë nga bankat pjesëmarrëse, deklaruan se presin që operacionalizimi i këtyre masave të ketë ndikim pozitiv duke nxitë rritjen e numrit të aplikacioneve për kredi dhe njëkohësisht rritje të kreditimit për kreditë investive për ndërmarrjet dhe kredive konsumuese për ekonomitë familjare. Sidoqoftë, tre banka nuk presin ndryshim të rëndësishëm në aktivitetin kreditor të tyre të bazuar në këto masa. Varësisht nga strategjia e kreditimit dhe struktura e portfolios kreditorë të bankave përkatëse, masat lehtësuese të ndryshme kanë relevancë të ndryshme. Nga bankat që presin ndikim pozitiv të masave në fjalë, katër prej tyre presin ndikim më të lartë në kreditimin për kredi konsumuese.

Gjatë vitit 2021, depozitat në sektorin bankar regjistruan rritje të theksuar, e veçanërisht ato nga ekonomitë familjare. Rritja vjetore e gjithsej depozitave deri në shtator 2021 ishte 15.1 përqind, ndërsa depozitat e ekonomive familjare u rritën për 18.3 përqind, këto rritje u konfirmuan edhe në pyetjen për qasje në financim (në seksionin 'Financimi'). Pyetja e radhës në anketë kishte për qëllim të elaboroj faktorët nxitës të kësaj rritje të depozitave. Në lidhje me këtë, bankat atribuon rritjen e konsiderueshme të depozitave hezitimit për investim nga subjektet ekonomike, si rezultat i pasigurive të rritura për shkak të dinamikave të pandemisë, dërgesës së lartë të remitencave, të cilat u rritën për 23.5 përqind për periudhën Janar- Shtator 2021/2020, si dhe vizitat në numër të lartë të diasporës në vend që nënkuptojnë remitencat e ardhura jashtë sistemit bankar. Një numër i vogël i bankave renditën si faktorë në rritje të financimit edhe përfitimin nga pakot lehtësuese ekonomike (pakot në mbështetje të bizneseve si dhe tërheqja e 10 përqind të kursimeve nga FKPK).

Përgjigjet e bankave të disagreguara për ndërmarrjet sipas sektorëve, tregojnë për kahjen e financimit të ekonomisë dhe dinamikat në sektorë të caktuar. Gjatë tremujorit të tretë, bazuar në lehtësimet e standardeve kreditorë, sektori i prodhimitarisë përbën sektorin me ofertën më të volitshme. Përgjigjet e dy bankave me rëndësi sistemike dhe me peshë të lartë në gjithsej kreditimin e sektorit deklaruan lehtësime të standardeve kreditorë për këtë sektor, njëra prej tyre deklaroi lehtësime të konsiderueshme, e që rezultoi në indeks pozitiv prej 0.21. Tutje, për kreditë ndaj sektorit të ndërtimtarisë dhe atij të patundshmërive banesore po ashtu u aplikuan standarde kreditorë të lehtësuara, saktësisht indeks pozitiv 0.15 për të dy sektorët. Njëkohësisht, edhe kushtet dhe rregullat u lehtësuan në masë më të lartë për kreditimin e sektorit të prodhimitarisë me indeks pozitiv 0.20. Sektorë tjerë me kushte dhe rregulla të lehtësuara ishin sektori i tregtisë dhe sektori i patundshmërive banesore, që rezultuan me indeks pozitiv 0.16. Për dallim nga anketa e kaluar ku dinamikat në kreditimin e sektorit të tregtisë u nxitën në një masë të madhe nga kërkesa kreditorë e rritur, këtë tremujor ky sektor u ndikua kryesisht nga oferta kreditorë e lehtësuara. Kërkesa më e lartë për kredi erdhi nga ndërmarrjet në sektorin e tregtisë me indeks prej 0.21, përderisa kërkesa nga sektorët tjerë ishte e ulët ose e pandryshueshme.

Për TM4 2021, bankat presin që standardet kreditorë të lehtësohen kryesisht për sektorin e prodhimit dhe atë të shërbimeve. Ngjashëm, edhe kushtet dhe rregullat pritjet të lehtësohen në masë më të madhe për sektorin e tregtisë, shërbimeve dhe atij të prodhimit. Njëkohësisht, kërkesa për kredi pritjet të vijë nga të gjithë sektorët, përveç sektorit të ndërtimtarisë i cili nuk pritjet të ketë ndryshim të rëndësishëm. Sektorin me kërkesën më të lartë për kredi pritjet të jetë ai i tregtisë, pasuar nga sektori i shërbimeve.

Pritjet për Inflacionin

Me qëllim të avancimit të kapaciteteve analitike dhe duke u bazuar në praktikat më të mira rajonale dhe më gjerë, BQK ankton institucionet financiare në vend, duke u mbështetur në hipotezën se institucionet financiare bartin praktikat më të mira nga bankat amë dhe kanë ekspertizën e duhur për të projektuar dinamikat e inflacionit. Si rezultat, nga tremujori i tretë i vitit 2019, AKB është pasuruar edhe me pyetje shitesë, që adresojnë pritjet e bankave komerciale për zhvillimet në çmime në vend, duke ndihmuar kështu dhe plotësuar analizat tona në aspektin e analizimit, modelimit dhe parashikimit.

Në pyetësorin e fundit, përveç deklarimit të bankave lidhur me vlerësimet që kanë për nivelin e inflacionit në tremujorin paraprak, pyetësi adreson edhe pritjet e bankave për tremujorin e katërt të vitit 2021 dhe për vitin 2021 në përgjithësi. Anketa shërben gjithashtu edhe si një mjet për identifikimin e faktorëve specifik që potencialisht mund të ndikojnë pritjet e bankave për nivelin e caktuar të inflacionit.

Metodologjia

Pritjet e inflacionit luajnë të paktën dy role të rëndësishme. Së pari, ofrojnë një statistikë përmbledhëse kuantifikuese për shkallën e inflacionit në të ardhmen, dhe së dyti, mund të përdoren për të vlerësuar besueshmërinë e objektivitetit të inflacionit të vendosur nga bankat qendrore.

Rëndësia e pritjeve të inflacionit është më e lartë për vendet të cilat e kanë adoptuar strategjinë e shënjestrimit të inflacionit. Për këto vende, pritjet e inflacionit, ndër të tjera, shërbejnë edhe si një tregues i besueshmërisë së publikut ndaj bankës qendrore. Nëse besohet se banka qendrore do të reagojë për të arritur objektivin, atëherë edhe pritjet e agjentëve ekonomik lidhur me shkallën e inflacionit do të ishin më pranë objektivit. Pritjet e inflacionit janë të rëndësishme edhe për bankat të cilat nuk posedojnë politikë monetare, duke qenë se shërbejnë si input i rëndësishëm në përcaktimin e çmimeve dhe pagave, si dhe në procesin e modelimit dhe parashikimit. Për më tepër, pritjet e inflacionit ndikojnë kërkesën agregate, që më pas ndikon ecurinë e inflacionit.

Për dallim nga inflacioni aktual i cili matet në mënyrë të drejtpërdrejtë, pritjet lidhur me inflacionin vlerësohen me metoda të tërthorta. Ndër më të përdorurat është anketimi i agjentëve ekonomikë: konsumatorëve, bizneseve, bankave komerciale, etj. BQK, për herë të parë ka filluar me vlerësimin e pritjeve për inflacionin në tremujorin e tretë të vitit 2019, fillimisht me bankat komerciale.

Vlerësimet që merren nga bankat komerciale janë të formës sasiore të shoqëruara edhe me shpërndarje të probabilitetit. Pritjet për inflacionin vlerësohen për horizonte të ndryshme kohore, fillimisht vlerësimet për tremujorin paraprak si dhe pritjet për tremujorin e ardhshëm dhe vitin aktual në përgjithësi. Mbledhja e informacionit përmes anketave pasohet nga procesi i sistemimit, përpunimit dhe agregimit për të gjetur mesataren e pritjeve të inflacionit nga bankat komerciale.

Përmbledhja e rezultateve

Bazuar në anketën e realizuar në tetor të vitit 2021, bankat kanë vlerësuar nivel më të lartë të inflacionit në tremujorin e tretë të vitit 2021 krahasuar me tremujorin paraprak dhe presin një ngritje akoma më të lartë në tremujorin e katërt të vitit 2021. Dinamikat që kanë karakterizuar lëvizjen e çmimeve gjatë periudhës raportuese u reflektuan në pritjet inflacioniste të bankave komerciale: 3.8 përqind në TM4 2021 nga 3.4 përqind sa e kanë vlerësuar për tremujorin paraprak (tabela 2). Për vitin 2021 bankat presin se niveli i inflacionit do të jetë 3.4 përqind nga 0.2 përqind sa ishte në vitin 2020. Anketa e realizuar përfshinë edhe efektet potenciale që presin bankat pas përballjes me pandeminë Covid-19.

Të dhënat e publikuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) për tremujorin e tretë të vitit 2021 sugjerojnë se norma mesatare vjetore e inflacionit ishte rreth 4.4 përqind. Pra, vlerësimi i bankave për nivelin e inflacionit ishte më i ulët krahasuar me të dhënat aktuale. Për tremujorin e katërt bankat presin se norma mesatare e inflacionit do të jetë 3.8 përqind. Katër banka presin që inflacioni do të jetë mbi 4 përqind, dy banka presin se inflacioni do të jetë në intervalin nga 3 deri në 4 përqind dhe tri banka tjera presin se inflacioni do të jetë nën 3 përqind.

Tabela 2. Pritja e inflacionit nga bankat, ndryshimi vjetor në përqindje

Bankat	TM3 2021	TM4 2021	2021
1	2.1%	2.3%	2.3%
2	4.9%	5.5%	5.5%
3	1.2%	2.4%	2.5%
4	4.4%	5.3%	3.1%
5	4.9%	5.0%	3.5%
6	4.0%	4.0%	3.5%
7	2.6%	3.0%	3.4%
8	3.8%	3.8%	3.8%
9	2.4%	2.9%	3.2%
Mesatarja	3.4%	3.8%	3.4%

Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.


Siç ilustron figura 8, shpërndarjet e raportuara të probabilitetit tregojnë një pasiguri relativisht të ulët në lidhje me rezultatin e ardhshëm të inflacionit, pasi shpërndarja e probabilitetit të bankave është e përqendruar në inflacionin e pritur.

Në komentet e tyre cilësore, bankat kanë cituar disa faktorë të mundshëm për rritjen e shkallës së inflacionit:

- ✓ Situata më optimiste sa i përket pandemisë - presin rritje të aktivitetit ekonomik dhe rrjedhimisht të nivelit të inflacionit;
- ✓ Pengesat e krijuara në zinxhirët e furnizimit si pasojë e pandemisë Covid-19, ku shumë kompani po e kanë të vështirë të gjejnë lëndë të para për të prodhuar produktet e tyre. Për më tepër, është rritur kostoja e transportit detar dhe kjo ka ndikuar në rritjen enorme të çmimeve, sidomos të vajit, derivateve, materialit ndërtimorë, etj.
- ✓ Zhvillimet e çmimeve në tregjet ndërkombëtare si dhe prodhimi i ulët në Kosovë dhe varësia e madhe e ekonomisë së vendit nga importet. I gjithë viti 2021 është shoqëruar me rritje të çmimeve të derivateve të naftës por edhe të kategorive të tjera ndërkohë që së fundmi kemi edhe rritje të çmimeve të energjisë, dinamika që janë reflektuar në rritjen e përgjithshme të çmimeve.

Pritjet e bankave për vitin 2021 janë në përputhje me trendin më të lartë të inflacionit krahasuar me vitin 2020 dhe duke pasur parasysh dinamikën me të cilat po karakterizohen çmimet në vend, pritjet e bankave janë realiste.

Grafik 8. Probabiliteti i inflacionit për TM4 2021 (boshti-x: pritjet e inflacionit, ndryshimi vjetor në përqindje; boshti-y: probabiliteti)



Burimi: Bankat komercial dhe kalkulumet e BQK-së.



Rr. Garibaldi, nr.33, 10000 Prishtinë,
Republika e Kosovës
Tel: +383 38 222 055; Fax: +383 38 243 763
Web: www.bqk-kos.org